

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 20.09.2019 (njezet zero nente, dymijë e nëntëmbëdhjetë), para zyrave te shoqerise Tirana Jone shpk, me seli në Njësia Bashkiake nr.9, Rruga "Muzakët", Kulla Arabe nr.19, Apartament nr.2 Tirane, u paraqitën Shitësi dhe Blerësi, të cilët redaktuan e këtë Kontrate Shit-Blerje Kuotash, me termat si më poshtë vijon:

z. Eriold Musabelliu, shtetas shqiptare, i biri i Qazimit, i datëlindjes 10.03.1983, lindur në Corovode Skrapar dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr.personal I30310007L, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "**Tirana Jone**" shpk, shoqëri e themeluar më 25.10.2018 dhe e regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit më datë 20.11.2018 me NIPT L82320044I, këtej e tutje quajtur "**Shitësi**";

DHE

z. Mario Prushi, shtetas shqiptare, i biri i Skenderit lindur në Kruje, më datë 30.12.1978 dhe banues ne Tirane, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr.personal H81230049U, këtej e tutje quajtur "**Blerësi**";

DUKE PATUR PARASYSH SE :

i. Blerësi është ne proces blerje te kuotës së shoqërisë me emërtim tregtar "**Tirana Jone**" SH.P.K., një Shoqëri e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë më datë 20.11.2018 me Numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) L82320044I me seli në Njësia Bashkiake nr.9, Rruga "Muzakët", Kulla Arabe nr.19, Apartament nr.2 Tirane , këtej e tutje quajtur "**Shoqëria**", dhe në këtë mënyrë do të bëhet Ortaku i Vetëm i Shoqërisë

ii. Shitësi është zotëruesues dhe posedues te padiskutueshëm të 100% kapitalit të shoqërisë (këtëj e tutje e quajtur kuota).

Ortaku i Shoqërisë **Z. Eriold Musabelliu** administratori i vetem i kësaj shoqerie zotëron 100% të kapitalit të kuotave në shoqëri.

iii. Shoqëria ka një kapital prej një mijë (1.000) Lekë, të ndarë në një kuotë të regjistruara dhe me vlerë nominale të kuotës prej 1000 (një mijë) Lekë, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht dhe në mënyrë të vlefshme.

Me vendimin e datës 10.09.2019 të Ortakut të shoqërisë është vendosur shitja e kuotave në masën 100% të tyre nga ana e Ortakut vetëm të Shoqërisë **Z. Eriold Musabelliu**, në masën 100%, të kapitalit të shoqërisë dhe blerjen e tyre nga ana e **z. Mario Prushi** në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Shitja në masën prej 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "**Tirana jone**" Sh.p.k. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë mbi kuotat e kapitalit themeltar të ortakut të shoqërisë **Z. Eriold Musabelliu**, në masën 100%, të kuotave të kapitalit të shoqërisë, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, të shprehur në vendimin e Ortakut, datë 10.09.2019.

Shitësi **Z. Eriold Musabelliu** është plotësisht dakord të shesi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë përkatësisht në masën prej 100% të kuotave që ai zotëron në shoqërinë "**Tirana Jone**" Sh.p.k. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit **z. Mario Prushi** ne masën 100 %.



Blerësi, z. **Mario Prushi** është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 100% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "**Tirana Jone**" Sh.p.k.

MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku **Z. Eriold Musabelliu** humbet pronësinë në masën 100%, të kuotave të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "**Tirana Jone**" Sh.p.k. dhe cilësinë e ortakut të shoqërisë, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotat e shoqërisë, ndërsa blerësi, bëhet pronar në masën z. **Mario Prushi** në masën 100% të kuotave të shitura.

Gjithashtu, në bazë të kësaj kontrate Blerësi do të mbajë përgjegjësi për të gjitha detyrimet e shoqërisë të cilat nuk i janë bërë të ditura atij në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe që kanë lindur para datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

Shoqëria Tregtare "**Tirana Jone**" Sh.p.k. pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si Ortak te saj te Vetëm me pjesëmarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:

- **Z. Mario Prushi** zotëron 100% të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë "**Tirana Jone**" Sh.p.k.. të barabartë me 1 (një) kuotë.

Shoqëria do të ketë administrator z. **Mario Prushi**.

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë "**Tirana Jone**" Sh.p.k. do të jetë shuma prej 1.000 (një mijë) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotave sipas Statutit të Shoqërisë. E gjitha shuma, për të cilën palët bien dakort të jetë e drejtë, i paguhet Shitësave nga Blerësi.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 3 kopje të njëjta në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë. Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan ne zyrat e shoqërisë, ju lexuan palëve kontraktuese, të cilët u shprehën se e kanë kuptuar dhe pranuar atë dhe të cilët e nënshkruajnë atë pa verejtje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë nënshkroi në prezencën e paleve.

SHITËSI

PALËT

BLERËSI

ERIOLD MUSABELLIU

Eriold Musabelliu



MARIO PRUSHI

Mario Prushi

